



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .10.2025

Lënda: Përgjigje kërkesës së paraqitur nga koordinatori institucionit

Drejtuar: Institutit të Studimeve Politike
Adresa: Rruga “Faik Konica”, Garden Side, Ap.3. Kati II-të

TIRANË

Të nderuar!

Në përgjigje të kërkesës tuaj drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti), me tonën nr. 1840 prot., datë 08.10.2025, me anë të së cilës kërkon: 1- vënien në dispozicion të listës me 25 zyrtarët që rezultojnë me të dhëna sa më të mundshme identifikuese dhe pozicionin ku kanë konkurruar/ janë emëruar, për të ndjekur këtë problematikë dhe me institucionet përkatëse; 2- vënien në dispozicion nëse ka, të të dhënave verifikuese për kandidatët për deputetë për zgjedhjet 2025 dhe 3- ecurinë e verifikimit përI.M., Ju informojmë se:

Së pari: Sa i takon listës me 25 zyrtarë që rezultojnë me të dhëna në dokumente të ish Sigurimit të Shtetit, ju bëjmë me dije se vetëm njëri prej kandidatëve të kësaj liste është verifikuar përpara emërimit/ngritjes në detyrë në pozicionet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 i ndryshuar, ndërsa 24 shtetasit e tjerë janë kandidatë të verifikuar në zbatim të ligjit nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në kuadër të propozimeve që bëhen pranë organeve të pushtetit vendor, për dhënien e titujve të nderit apo për emërtimin e hapësirave publike.

Në faqen zyrtare të Autoritetit është pasqyruar në formatin e kërkuar nga ligji Vendimi nr. 727 datë 19.12.2024 i Autoritetit në dispozitivin e të cilit është vendosur:

1.Të informojë institucionin Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për informacionin që kërkohet me shkresën nr. 112 prot. datë 04.12.2024, “Kërkesë” për verifikimin e pastërtisë së figurës, përpara emërimit të kandidatit për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, se:

- a) Znj. N.M. rezulton në pesë çështje penale të arshivuara në Arkivin e Sistemit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të administruar nga Autoriteti, në detyrën (cilësinë) e Prokurorit në rrethin Fier, në vitet 1988 dhe 1989, në ngarkim të disa të pandehurve për akuzat, Agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor, vepër penale e parashikuar nga neni 55/1 i Kodit Penal, dhe Tradhtisë ndaj atdheut parashikuar nga neni 47 i Kodit Penal në Kreun, “Krime kundër shtetit”, të cilat bëjnë pjesë në kategorinë e veprave penale të përkufizuara në ligjin nr. 7514, datë

30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar dhe hyjnë në fushën e veprimit të ligjit 45/2015.

Së dyti: Pavarësisht shkresave të drejtuara gjithë subjekteve politike (53 të regjistruara të cilave ju dërgua shkresa) vetëm 6 kandidatë me iniciativë personale kanë paraqitur kërkesë për verifikim. Në përfundim të procesit të verifikimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë në emër të tyre.

Së treti: Në zbatim të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, Autoriteti vihet në lëvizje për verifikimin e figurës për çdo kandidat vetëm pas një kërkesë të paraqitur nga institucion kushtetues apo autoritet publik, nga subjektet politike/kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij, **dhe jo kryesisht pra me iniciativë të tij**. Vetëm në kushtet kur është paraqitur një kërkesë për verifikim dhe në masën dhe për qëllimet që e lejon ky ligj, lind detyrimi i Autoritetit që *“t’i përgjigjet çdo kërkesë të institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t’u emëruar ose ngritur në detyra”* siç përcakton qartë neni 29 i ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar.

Pranë Autoritetit, nga institucioni i Kuvendit të Shqipërisë, në vitin 2017 është paraqitur kërkesë për verifikim figure për shtetasin I. M.. Komunikimi me Kuvendin për këtë çështje është bërë në zbatim të ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar, duke **informuar** dhe **konfirmuar** se shtetasi, disponon certifikatën e pastërtisë së figurës dhënë nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit nr. 8001, datë 22.9.1995, “Për gjenocidin dhe krimet kundër njerëzimit kryer në Shqipëri gjatë sundimit komunist për motive politike, ideologjike dhe fetare”, si dhe ligjit nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, Autoriteti nuk ka kryer proces verifikimi të figurës së shtetasit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit
L. Cocoli

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Sofi Noti

Miratoi: E. Shtino
Konceptoi: L. Cocoli
Datë: 20.10.2025